

**VENDIM**  
**Nr. 123, datë 29.7.2019**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OSHEE  
SHA PËR NJË NDRYSHIM NË “RREGULLOREN PËR PROCEDURAT E BLERJES  
SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E  
SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN E ENERGJISË  
ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË  
SHËRBIMIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, germa “I”, neni 62, pika 2, nenit 69, germa “ë”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” i ndryshuar, nenit 21, të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, i ndryshuar; nenit 19, germa “P” dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 29.7.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga drejtoritë teknike, mbi shqyrtimin e kërkesës së OSHEE sh.a., për një ndryshim në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

Konstatoi se:

OSHEE sh.a., me anë të shkresës nr. 14321 prot., datë 3.7.2019, protokolluar me tonën nr. 436, datë 4.7.2019, ka kërkuar në ERE një ndryshim në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, konkretisht në nenin 20 të saj që lidhet me pagesat dhe faturimin, duke propozuar që afatet e pagesave të jenë të negociushme nga palët.

- Ky propozim është rrjedhojë e situatave financiare me të cilat OSHEE sh.a është përballur gjatë viteve të fundit, ku për shkakë kryesisht të situatave ekstreme hidrike, OSHEE është gjendur në vështirësi të theksuara likuiditeti.

- OSHEE sh.a., për muajt e parë të vitit 2019 është përballur me blerje të sasive të konsiderueshme të energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Shoqëria OSHEE sh.a., e ka bazuar propozimin e saj dhe në respektim të parashikimeve të “Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, të miratuara me vendimin nr. 139, datë 15.8.2016 nga bordi i ERE-s, e konkretisht tek rregullat për kontratat dypalëshe, V.I, konfidencialiteti i kontratave lirisht të negociuara, ku përcaktohet se kontratat e shitblerjes së energjisë elektrike mund të jenë të rregulluara me një përmbajtje minimale të përcaktuar nga ERE ose të jenë të parregulluara, me përmbajtje të përcaktuar nga palët nëpërmjet negociatave direkte, që respektojnë dispozitat e Rregullave të Tregut dhe aktet e tjera të miratuara nga ERE.

- Përveç analizës dhe kushteve të mësipërme financiare, propozimi i OSHEE sh.a. mbështetet edhe në faktin se shoqëritë pjesëmarrëse në procedurat e blerjes së energjisë elektrike të realizuara gjatë vitit 2019 kanë pranuar propozimin e OSHEE sh.a., për ndryshimin e parashikimit për afatin e

kryerjes së pagesës, duke rënë dakord me vullnet të lirë për kryerjen e saj brenda afatit 180-ditor nga dita e fundit e lëvrimit.

- Në lidhje me sa më sipër sqarojmë se, OSHEE sh.a. edhe më herët nëpërmjet komunikimeve të vazhdueshme nisur nga situata financiare në të cilën ndodhet shoqëria, ka kërkuar që për një periudhë tranzitore për procedurat e blerjes së energjisë në treg të parregulluar që zhvillohen nga OSHEE sh.a. deri në fund të vitit 2019, pagesa e futurës së blerjes së energjisë elektrike të bëhet nga blerësi brenda 180 ditëve nga dita e fundit e lëvrimit.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 46, datë 19.3.2019 ka vendosur ndër të tjera siç përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit "... Vendosjen e një periudhe tranzitore prej 3-muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, gjatë së cilës afati i kryerjes së pagesave nga shoqëria OSHEE sh.a. për tregtarët fitues të ankandeve të shitblerjes së energjisë elektrike me qëllim sigurimin e energjisë elektrike për përmbushjen e nevojave të klientëve fundorë, mund të jetë jo më vonë se 180 ditë nga dita e lëvrimit të energjisë elektrike..."

- Në përfundim të afatit të miratuar me vendimin sipërcituar, si dhe pas përsëritjes së kërkesës së OSHEE sh.a., për zgjatjen e periudhës tranzitore, bordi i ERE me vendimin nr. 97, datë 21.6.2019, ka pranuar kërkesën duke vendosur zgjatjen e këtij afati deri më 30.9.2019.

Sa më sipër, referuar shkresës së OSHEE sh.a. nr. 14321 prot., datë 3.7.2019, nuk i jep zgjidhje afatgjatë problematikave të cilat kanë çuar në këto vendimmarrje dhe cituar me sipër.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OSHEE sh.a. mbi një ndryshim në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", si më poshtë:

- Nenin 20, germa "a", "... pagesa do të bëhet nga blerësi sipas afatit të negociuar dhe vendosur midis palëve në kontratë".

2. OSHEE sh.a. të japë sqarime që lidhen me ndryshimet e propozuara në pikën 1 të këtij vendimi, në lidhje me kushtet e shpalljes së ofertës për blerjen e energjisë elektrike si dhe kushtet e negociimit të afatit të pagesave, duke garantuar një proces të drejtë e të ligjshëm për të gjithë tregtarët pjesëmarrës.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a., Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkolet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**